



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2021:224225

Datë: 18.03.2024

Numri i dokumentit: 05465427

C.nr. 999/2021

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Berkan Hamza, në çështjen juridike kontestimore të paditësit N (A) H nga fshati Ratkoc, Komuna e Rahovecit, ndaj të paditurit V (G) K nga fshati Ratkoc, Komuna e Rahovecit, për shkak të objektit të kontestit – kthimi i borxhit, me vlerën e objektit të kontestit prej 1,700.00 euro, jashtë seancës, më datën 18.03.2024 merr këtë:

A K T V E N D I M

KONSIDEROHET E TËRHEQUR padia e paditësit N (A) H nga fshati Ratkoc, Komuna e Rahovecit, ndaj të paditurit V (G) K nga fshati Ratkoc, Komuna e Rahovecit, në çështjen juridike kontestimore, C.nr. 999/2021.

Secila palë i bartë shpenzimet e procedurës kontestimore.

A r s y e t i m

Paditësi N (A) H nga fshati Ratkoc, Komuna e Rahovecit, në këtë gjykatë më datën 05.10.2021, ka parashtruar padinë kundër të paditurit V (G) K nga fshati Ratkoc, Komuna e Rahovecit, për shkak të objektit të kontestit – kthimi i borxhit, me vlerën e objektit të kontestit prej 1,700.00 euro.

Lidhur me këtë çështje kontestimore, kjo gjykatë të paditurit i ka dërguar aktvendimin me numër C.nr.999/2021 të datës 27.12.2022 për përgjigjen në padi, por e njëjta është kthyer me konstatimin se tentim dorëzimi është bërë më datën 11.01.2023, por pala e kërkuar jeton jashtë shtetit, në Francë.

Meqenëse dorëzimi është tentuar të bëhet në pajtueshmëri me nenin 110 të LPK-së dhe nga dorëzuesi i shkresave është konstatuar se i njëjti jeton në Francë dhe adresën e ka të panjohur, gjykata me aktvendimin C.nr.999/2021 të datës 15.01.2024 ka detyruar paditësin që në afat prej 7 ditëve nga dita e pranimi të këtij aktvendimi ta sigurojnë adresën e saktë të të paditurit ose të propozojnë caktimin e përfaqësuesit të përkohshëm, me pasuesin që nëse nuk vepron sipas këtij aktvendimi padia e paditëses do të konsiderohet e tërhequr.

Kështu, gjykata ka vendosur që ta konsiderojë të tërhequr padinë e paditësit për faktin se nga dita kur paditësi ka pranuar aktvendimin e kësaj gjykate me të cilën e ka detyruar paditësin për

sigurimin e adresës së saktë të të paditurit, i njëjti përkundër faktit se ka kaluar afati i paraparë 7 ditor, nuk kanë vepruar fare sipas aktvendimit të kësaj gjykate. Sipas nenit 99.2 të LPK-së parashihet që *“Parashtresat duhet të jenë të kuptueshme dhe të përmbajnë çdo gjë që nevojitet dhe e mundëson veprimin sipas tyre. Ato duhet të përmbajnë sidomos: emrin e gjykatës, emrin dhe mbiemrin (emërtimin e personit juridik), vendbanimin apo vendqëndrimin (selinë e personit juridik) e palëve, të përfaqësuesve të tyre ligjor apo me prokurë, po që se i kanë, objektin e kontestit, përmbajtjen e deklaratës dhe firmën e parashtruesit.”* Ndërsa në neni 102.3 të LPK-së parashihet se *“Do të konsiderohet se është tërhequr parashtresa po që se nuk i kthehet gjykatës brenda afatit të caktuar, e në qoftë se i kthehet pa u korrigjuar, gjegjësisht pa u plotësuar, parashtresa do të hidhet poshtë.”*

Vendimi mbi shpenzimet procedurale, që secila palë t'i bartë këto shpenzime, është marrë në kuptim të nenit 450 të LPK-së pasi që secila palë paraprakisht vet i bartë harxhimet që i ka shkaktuar me veprimet procedurale të veta.

Prandaj, nga ajo që u tha më lartë, kjo gjykatë vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, e në bazë të nenit 99 dhe 102 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil

C.nr.999/2021, më datën 18.03.2024

Gjyqtari
Berkan Hamza

KËSHILLË JURDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit.